



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE TE BRËNDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT

Nr. 1326 Prot

Kopje 1 ;
Tiranë më 27.07 /2020.

URDHËR

Nr. 64 , datë, 27.07.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR HAPAT PROCEDURALË TË UNIFIKUAR”

Në mbështetje të gërmës “a” të nenit 3, nenit 12 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, nenit 7 të Rregullores së Shërbimit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.829, datë 03.12.2014, ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për hapat proceduralë të unifikuar”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.
3. Për kontrollin e zbatimit të këtij Urdhri ngarkohet Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së dhe Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Muhamet RRUMBULLAKU



RREGULLORE

PËR

**HAPAT PROCEDURALË
TË UNIFIKUAR**

**Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e
Brendshme dhe Ankesat**

Nr. 64 datë 27.07.2020

KREUI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe hapave proceduralë ndiqen gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve nga trupa e vlerësimit.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
 - a) rregullave dhe procedurave për komunikimin e trupës së vlerësimit me subjektin;
 - b) rregullave dhe procedurave për hetimin dhe përfundimin e procesit të vlerësimit;
 - c) rregullave dhe procedurave për zhvillimin e seancave dëgjimore dhe shpalljen e vendimit për subjektin e vlerësimit.

Neni 3

Parimet e veprimtarisë

1. Gjatë veprimtarisë verifikuese dhe vlerësuese të subjekteve të vlerësimit sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, trupat vlerësuese e ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke zbatuar parimin e:
 - a) transparencës;
 - b) të drejtës për informim;
 - c) konfidencialitetit, ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i SHÇBA-së” është personi i emëruar në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.
2. “Punonjës policie” është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.

3. “Punonjës i Gardës së Republikës” është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

4. “Subjekt vlerësimi” janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe ish-punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 5, të ligjit 12/2018.

5. “Grup vlerësimi” është njësi e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.

6. “Procesi i vlerësimit” përfshin si procesin kalimtar, ashtu dhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.

7. “Partnerë ndërkombëtarë” janë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve.

KREU II

HAPAT PROCEDURALE

Neni 5

Mbledhjet e trupave të vlerësimit

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përcaktimi i subjekteve të vlerësimit sipas shortit të hedhur, çdo trupë vlerësuese zhvillon mbledhjen e parë, gjatë së cilës:

a) Deklarohet konflikti i interesit nga anëtarët e trupës vlerësuese;

b) Zgjidhet kryesuesi i trupës vlerësuese për çdo subjekt;

c) Bëhet prezantimi paraprak i dosjes nga çdo relator;

ç) Vendoset për njoftimin e subjektit të vlerësimit për fillimin e procedurave të vlerësimit; njohjen me përbërjen e trupës dhe të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e pyetësorit tip;

d) Vendoset për fillimin e hetimit kryesisht, si dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit.

Neni 6

Komunikimi me subjektet i trupës së vlerësimit

1. Trupa vlerësuese e caktuar me short për vlerësimin e subjektit, është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit deri në përfundim të tij sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
2. Trupa vlerësuese bën njoftimin si dhe çdo komunikim me subjektin e vlerësimit, në adresën elektronike të vendosur nga vetë subjekti i vlerësimit në deklaratën e pasurisë.
3. Në rast se njoftimi nuk realizohet me anë të adresës elektronike, trupa e vlerësimit përdor forma të tjera të komunikimit, parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.
4. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, relatori mund t'i drejtojë subjektit pyetje shitesë, të cilat i konsideron të nevojshme për hetimin.

Neni 7

Hapat që ndiqen për përfundimin e procesit të vlerësimit

1. Relatori i çështjes, pasi studion dosjen, ndërmerr hapat proceduralë për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës vlerësuese.
2. Në përfundim të hetimit kryesisht si dhe vlerësimit të fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit, relatori, përgatit relacionin paraprak të hetimit, ua përcjell anëtarëve të trupës dhe njofton kryesuesin për thirrjen e mbledhjes së trupës.
3. Pas dëgjimit të relatorit, trupa vlerësuese shqyrton gjetjet dhe/ose jep opinionin për vazhdimin e hetimit kryesisht ose mbyllet e tij.
4. Në rast të vazhdimit të hetimit kryesisht, relatori merr masa për kryerjen e procedurës së nevojshme.
5. Kur trupa gjykon se janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm hetimorë për përfundimin e hetimit kryesisht, merr vendim për (i) përfundimin e tij si dhe (ii) njoftimin e subjektit për:
 - a) Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - b) Rezultatet e këtij hetimi;
 - c) Provat nëse ato kanë nivelin e provueshmërisë, sipas dispozitave të ligjit nr.12/2018
 - c) Kalimin e barrës së provës tek subjekti i vlerësimit.

Neni 8

Të drejtat e subjektit në lidhje me procesin

1. Subjekti i vlerësimit ka të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së krijuar për vlerësimin e tij, si dhe të marrjes së një kopje të tyre.

2. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Subjekti ka të drejtën për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të pritshëm.

4. Njohja me dosjen bëhet brenda afatit të përcaktuar nga trupa vlerësuese nëpërmjet kërkesës me shkrim të subjektit. Ky afat nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u njohur me dosjen.

5. Subjekti ka të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit me anëtarët e trupës vlerësuese. Në këtë rast përjashtimi i anëtarit do të vendoset nga një trupë tjetër vlerësuese, ndërsa anëtari zëvendësues do të caktohet me short.

6. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit për thirrjen e një dëshmitari apo marrjen e një prove, trupa vlerësuese, vendos me arsyetim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në rast se kjo kërkesë pranohet, relatori i çështjes ka detyrimin të marrë deklarimin/provën mbështetëse, ta vlerësojë atë dhe ta përfshijë në relacionin përfundimtar.

7. Në rast se dosjes së një subjekti të vlerësimit, i cili e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për t'u njohur me dosjen, i shtohen prova apo fakte të reja, që ndikojnë në vendimmarrje, për të cilat subjekti nuk ka marrë dijeni, ky subjekt do të njoftohet përsëri për t'u njohur me to sipas procedurës më sipër.

Neni 9

Seancat dëgjimore

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, kur dosja është gati dhe ka përfunduar afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori përgatit relacionin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion trupës së vlerësimit.

2. Trupa e vlerësimit, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi, mund të vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore.

3. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u dëgjuar në seancë.

4. Seanca dëgjimore është publike dhe zhvillohet sipas përcaktimeve në nenin 20 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

5. Seanca dëgjimore hapet nga kryesuesi i trupës vlerësuese, i cili pasi identifikon subjektin e vlerësimit dhe/ose përfaqësuesin e tij, prezanton trupën vlerësuese dhe ia jep fjalën relatorit të çështjes.

6. Relatori i çështjes bën një përmbledhje të shkurtër të dosjes, si dhe të hapave proceduralë hetimorë të ndërmarrë. Pas relatorit, i jepet fjala subjektit të vlerësimit/përfaqësuesit të tij, për të bërë një deklaratë fillestare mbi themelin e çështjes.

Koha e caktuar për këtë mund të kufizohet në mënyrë të arsyeshme nga kryesuesi i trupës vlerësuese.

6. Në rast se subjekti pranon t'u përgjigjet pyetjeve, anëtarët e trupës mund t'i drejtojnë pyetje në lidhje me çdo çështje objekt vlerësimi.

7. Në përfundim të seancës, subjekti i vlerësimit mund të bëjë një deklaratë përmbyllëse, koha e së cilës përcaktohet nga kryesuesi i trupës.

Neni 10

Shpallja e vendimit

1. Bisedimet për marrjen e vendimit bëhen në përputhje me ligjin.
2. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore nga kryesuesi i trupës vlerësuese.
3. Vendimi me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit.
4. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit duke respektuar kërkesat e ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".